



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2537 prot.

Fushë-Arrëz, më 25.08.2025

PROCESVERBAL I DËGJESËS PUBLIKE

“MBI DRAFTIN E PLANIT SOCIAL VENDOR TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ 2025-2028” (Zbardhur, më 25.08.2025)

I mbajtur sot, më 21.08.2025.

Vendi: Në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

Ora:10:00

Në takim marrin pjesë:

Mikel Qafa, Zëvendëskryetar Bashkie;

Sidorela Katroshi, Drejtoreshë në Drejtorinë e Çeshtjeve Sociale;

Lindita Lleshi, Specialiste në e Sektorin e Çeshtjeve Sociale;

Albina Prenga, Specialiste e IT në bashki;

Naze Selimaj, Sekretare e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz.

Të pranishëm në këtë konsultë janë këshilltarë të Këshillit Bashkiak, përfaqësues të administratës së bashkisë, institucioneve vendore, shoqërisë civile, grupe interesi dhe banorë të bashkisë.



Naze Selimaj, Sekretare e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, përshëndet dhe falenderon të pranishmit në takim si dhe bën prezantimin e ekipit të bashkisë dhe të temës së diskutimit të dëgjësës publike mbi “Draftin e Planit Social Vendor të Bashkisë Fushë-Arrëz 2025-2028”.

Fjalën hapëse e mbajti **Mikel Qafa**, Zëvendëskryetar Bashkisë:

Të nderuar qytetarë, përfaqësues të institucioneve, organizatave të shoqërisë civile!
Është kënaqësi e veçantë për mua që sot hapim këtë dëgjësë publike për prezantimin e draftit të Planit Social të Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën 2025–2028. Ky proces është një hap i rëndësishëm në përpjekjet tona për të ndërtuar një bashki më gjithëpërfshirëse, ku çdo qytetar, pavarësisht moshës, gjinisë, gjendjes ekonomike apo shëndetësore, të ndihet i mbështetur dhe i përfaqësuar.

Ky plan është hartuar mbi bazën e analizave, konsultimeve dhe rekomandimeve nga aktorë të shumtë lokalë dhe kombëtarë, si dhe mbi nevojat konkrete që kemi identifikuar në terren. Ai përcakton prioritetet tona në shërbimet sociale, mbrojtjen e shtresave në nevojë, fuqizimin e të rinjve, përmirësimin e kushteve për të moshuarit, si dhe nxitjen e përfshirjes dhe barazisë sociale. Ne jemi të bindur se një plan i mirë nuk mund të jetë produkt vetëm i administratës së bashkisë. Plani duhet të ndërtohet bashkë me qytetarët, me shoqërinë civile, me partnerët tanë, sepse vetëm kështu ai bëhet realisht zë i komunitetit. Prandaj dëgjesa e sotme është një mundësi e vyer për të ndarë me ju objektivat, masat dhe pritshmëritë tona, por mbi të gjitha për të marrë mendimet, sugjerimet dhe shqetësimet tuaja.

Jam i bindur se bashkë do të arrijmë të finalizojmë një dokument vizionar, të zbatueshëm dhe mbi të gjitha të dobishëm për çdo qytetar të bashkisë sonë.



Në vazhdim fjalën e merr, **Sidorela Katroshi**, Drejtoreshë në Drejtorinë e Çështjeve Sociale:

Faleminderit dhe mirë se keni ardhë në këtë dëgjësë konsultative ku pjesëmarrja tregon se interesi juaj dhe padyshim besimi ndaj sektorëve të pushtetit vendor po vjen duke u rritur. Jemi këtu për të dëgjuar zërin tuaj me vëmendje dhe për të marrë

mendimet dhe rekomandimet tuaja lidhur draftin e Planit Social Vendor të Bashkisë Fushë-Arrëz 2025-2028”.

Sidorela Katroshi, Drejtoreshë në Drejtorinë e Çeshtjeve Sociale:

Plani Social Vendor i Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën 2025–2028 është ndërtuar mbi një vizion të qartë për ndërtimin e një bashkie gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, ku çdo qytetar ka mundësi të barabarta për të jetuar me dinjitet dhe për të qenë pjesë aktive e zhvillimit komunitar. Dokumenti është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, përmes një procesi të orientuar nga vetë bashkia.



Plani përmban 3 prioritete strategjike:

- Zhvillimi i shërbimeve sociale të strukturara dhe të specializuara për grupet në nevojë;
- Përfshirja sociale dhe fuqizimi ekonomik i individëve vulnerabël përmes aftësimit, punësimit dhe pjesëmarrjes në zhvillimin lokal;
- Ngritja e kapaciteteve institucionale dhe forcimi i partneriteteve për një sistem të qëndrueshëm të mbrojtjes sociale.

Mbeshtetur në Ligjin 139/2015 "Për qeverisjen vendore", Ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Shqipëri" përgatitja dhe zbatimi i Planit Social është detyrim ligjor i njësive të vetëqeverisjes vendore.

Dokumenti në vijim është i organizuar në dy pjesë: Pjesa e parë përmban Raportin e Vlerësimit të Nevojave, i cili jep të dhëna të detajuara mbi situatën egzistuese në këndvështrimin e organizimit, strukturave dhe kapaciteteve të stafit lokal të shërbimeve të kujdesit shoqëror, individëve dhe grupeve në nevojë në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz, shërbimeve egzistuese në territor.

Pjesa e dytë përmban Planin Social të Bashkisë Fushë-Arrëz, i cili hartohet mbi bazën e nevojave për shërbime të identifikuara të individëve dhe grupeve në nevojë në territorin e Bashkisë, kuadrin ligjor, strategjitë dhe standartet kombëtare specifike, si dhe politikat lokale të zhvillimit. Metodologjia ku ne jemi mbështetur është pjesë e metodologjisë së ndjekur nga shërbimi social kombëtar për politika lokale dhe synon një pnoramë të plotë nëpërmjet:

- a) Të dhënave demografike bazë; b) Profilin dhe karakteristikat e përdoruesve të shërbimit;
- c) Shërbimeve egzistuese në territorin e Bashkisë ose që përfshin dhe Bashkinë;
- d) Shpërndarja e shërbimeve në territor; e) Financimi i shërbimeve aktuale;
- f) Të dhënave mbi strukturat e ngritura në Bashki dhe Njësi Administrative në përputhje me ligjin;

g) Të dhënave krahasuese mbi buxhetin e bashkisë për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe shpërndarjen e tij.

Jemi përpjekur të kemi një vlerësim real të nevojave në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë

Fushë-Arrëz, duke u mbështetur edhe në ofrues publik dhe

jo publik ekzistues të kujdesit shoqëror në Bashkinë Fushë-Arrëz,

organizatave jo qeveritare që operojnë në territorin e Bashkisë, përfaqësues nga sistemi arsimor, shëndetësor etj. Në rast kur mungojnë shërbimet e ngritura nga institucionet publike, këto shërbime kontrahohen nga organizatat jo-fitimprurëse apo ofrues të tjerë të shërbimeve.

Kjo do të zvogëlonte kostot e ngritjes dhe kohën dhe do të lejonte fleksibilitet më të madh në ofrimin e shërbimit duke u mbështetur në nevojat specifike të individëve dhe familjeve në nevojë. Në këtë studim janë specifikuar edhe financimet e shërbimeve të kujdesit shoqëror, nga se përbëhen ato, roli i bashkisë në ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, struktura përgjegjëse, gjendja ekzistuese e strukturave të Njësive Vendore, shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe grupeve në nevojë.

Në këtë aspekt është bërë një vështrim i përgjithshëm shoqëror dhe social më të dhëna të specifikuar në nr. i popullsisë, shtrirjen dhe përbërjen e Njësive Administrative (shpërndarje e popullsisë), të dhëna për persona me aftësi ndryshe, familje të pastreha. Të gjitha këto kanë si

objektiv; Fuqizimin e strukturave dhe kapaciteteve të shërbimeve sociale të Bashkisë, zhvillimin dhe qasjen ndërsektoriale në menaxhimin e rasteve sociale, ngritjen dhe funksionimin i rrjetit lokal të koordinuar të shërbimeve të kujdesit shoqëror, mbrojtjen dhe riintegrimin e familjeve në nevojë.

Si përfundim vetë përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror do të kenë zë në vlerësimin e tyre, pasi plani përmban aktivitete që bashkia të ngrejë mekanizma për të marrë mendimin e tyre në vendimarrje të rëndësishme, siç është edhe zbatimi dhe rishikimi i këtij plani.

Faleminderit!



Ardmir Doda, Drejtor në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, falenderon Sektorin e Çeshtjeve Sociale dhe uron shumë suksese, ky është një plan strategjik dhe do të na shërbejë shumë. Ky plan parashikon të gjitha masat e ndërhyrjes për shtresat në nevojë. Zbatimi i këtij plani kërkon angazhim dhe përkushtim.

Pashk Prendi, Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Publike:

Falenderime për të gjithë aktorët që kanë marrë pjesë në ndërtimin e këtij drafti të planit social vendor dhe uroj të kemi realizim të objektivave që synon ky plan.

Naze Selimaj, Sekretare e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz:

Meqenëse nuk ka diskutime të mëtejshme dëgjesa mbyllet këtu duke ju falenderuar për përkushtimin dhe angazhimin tuaj!

SEKRETAR

Naze SELIMAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË DËGJESË PUBLIKE ME TEMË:
“ DRAFTI I PLANIT VENDOR SOCIAL DHE I STREHIMIT 2025-2028 PËR BASHKINË
FUSHË-ARRËZ”

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	Bardhe Gjini		F-Arrëz		
2.	Vezirë Zepa		F-Arrëz		
3.	Mirela Memaj		F-Arrëz		
4.	Edlira Pepaj		F-Arrëz		
5.	Valentina Furoku		B. F-Arrëz		
6.	Vitore Preza		B. Fushë-Arrëz		
7.	Valbona Milla		B. F. A		
8.	Lindita Lleshi		B. F. A		
9.	Parlek Gjeuri		B. F. A		
10.	Pamela Gjinaj		B. F. A		
11.	Mikel Qafa		B. F. A	Zv. Kryetar	
12.	Nexhmije Katroski		B. F. A	Qytetare	
13.	Sose Lushaj		B. F. A	Qytetare	
14.	Fide Lleshi		Qytetare		
15.	ELVIN HAXHA		Prishtar		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË DËGJESË PUBLIKE ME TEMË:
“ DRAFTI I PLANIT VENDOR SOCIAL DHE I STREHIMIT 2025-2028 PËR BASHKINË
FUSHË-ARRËZ”

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	LULJETA	SOBA	Bashkia Fushë Arrëz	Specialiste Auditi	
2.	Entela	Pepa	Bashkia Fushë-Arrëz	Përgj. Auditi	
3.	GJOK	ANIRIA	BASHKIA FUSHË-ARRËZ	IMP. PK	
4.	DED	LLESHI	BASHKIA F. ARRËZ	SPECIALIST MËNAXHIER	
5.	Zahir	Alija	B. Fushë-Arrëz	Përgj. dek. Menaxh. Ryj.	
6.	ARDMIR	OSHA	B-FA	DREJTOR	
7.	Sidorica	Katrosi	B. FA	Drejtoreshe	
8.	Fatona	Selimaj	B. FA	Drejtoreshe	
9.	Gjoke	Nikolli		Bashkia	
10.	YLBER	VOERRI	B-FA	INSPEKTOR	
11.	Aldi	Zeponi	B-FA	specialist s. juridike	
12.	Desara	Zoca	B-FA	specialiste e Burrime dferenc	
13.	Redona	Hasani	B-FA	Përgj. Juriste	
14.	Dorika	Marku	B-FA	Ps - GjF	
15.	Albin	Emgjell	B-FA	Sp - QRSio	
16.	Naze	Selimaj	Fushë-Arrëz	Sekretare e KB.	